

**VENDIM**  
**Nr.9, datë 25.1.2008**

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE SHOQËRISË “OSSH” SHA**

Në zbatim të nenit 9, nenit 13, pika 1, germa ç, nenit 14, pika 1, si dhe nenit 15, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.862, datë 20.12.2006 “Për krijimin e shoqërisë, “OSSH” sh.a., dhe nenit 10, pika 1, nenit 16, germa a, dhe nenit 19, pika 1 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.21, datë 4.4.2007, “Rregullores për procedurat e licencimit”, Bordi i Komisionerëve të ERES-s, në mbledhjen e tij të datës 25.1.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “OSSH” sh.a për marrje licence për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike,

**VENDOSI:**

1.Dhënien e licencës për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike shoqërisë “OSSH” sh.a. për periudhën nga 25.1.2008 deri më 25.1.2012.

2. Kjo licencë jepet me kushtin që:

a) Shoqëria “OSSH” sh.a., brenda datës 31.12.2008, të bëjë sigurimin e aktivitetit të furnizimit të energjisë elektrike në përputhje me “Rregullat për procedurat e licencimit”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**